



Alberta Boskany
A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1231 / Prot. 1

Vlorë më, 22. 06 2023

VENDIM
Nr. 13, datë 21.06.2023

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
"BACHELOR NË INXHINIERI MEKANIKE" MIDIS UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORË DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË BARIT, ITALI

Në mbështetje të nenit 49, 71, 75, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 25 të Statutit të Uv-së, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", Vendimit të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare, datë 19.06.2023 për çeljen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinierinë mekanike, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit në Itali, si dhe referuar Vendimit nr.31 të Senatit Akademik datë 20.06.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.06.2023,


VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare për hapjen e programit të përbashkët në ciklin e parë të studimit " Bachelor në Inxhinieri Mekanike"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1209/Prot.

Vlorë më, 20.06.2023

VENDIM
Nr. 31, datë 20.06.2023.

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
"BACHELOR NË INXHINIERI MEKANIKE" MIDIS UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË BARIT, ITALI

Në mbështetje të nenit 38, 71, 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", si dhe referuar Vendimit të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare, datë 19.06.2023 për celjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinierinë mekanike, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit në Itali, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 20.06.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe teknologjive detare për hapjen e programit të përbashkët ciklit të parë Bachelor në Inxhinierinë Mekanike, program studimi në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit, Itali. (Bashkëlidhur materiali përkatës).
2. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland Mibi

